



Webinare mbi shfrytëzimin e standardit vullnetar për NVM-të

**Avancimi i raportimit të qëndrueshmërisë
së NVM-ve**

16 dhe 23 tetor 2025

Webinare mbi shfrytëzimin e standardit vullnetar për NVM-të

Avancimi i raportimit të qëndrueshmërisë së NVM-ve

16 dhe 23 tetor 2025

HYRJE

Raportimi i qëndrueshmërisë ofron transparencë dhe llogaridhënie duke i lejuar subjektet të komunikojnë rreziqet dhe mundësitë e tyre të lidhura me qëndrueshmërinë për palët e ndërlidhura. Raportimi poashtu ndihmon në identifikimin e këtyre faktorëve, nxitjen e besimit dhe rritjen e reputacionit të korporatave.

Qendra e Bankës Botërore për reformën në raportim financiar dhe të qëndrueshmërisë (CFRR) po organizon dy webinarë, në bashkëpunim me [EFRAG](#), për të rritur ndërgjegjësimin midis rregullatorëve ligjorë, politikëbërësve, pjesëmarrësve të tregut dhe palëve të tjera të interesuara në vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) mbi shfrytëzimin e Standardit vullnetar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (VSME) si dhe për të adresuar sfidat kryesore në raportimin e qëndrueshmërisë.

Zhvilluar nga EFRAG, standardi VSME u miratua nga Komisioni Evropian përmes një rekomandimi të miratuar më 30 korrik 2025.¹ Qëllimi i tij kryesor është të mbështesë subjektet që bien jashtë fushëveprimit të Direktivës së BE-së për *Raportimin e Qëndrueshmërisë së Korporatave (CSRD)* në trajtimin e kërkesave për informacion nga institucionet financiare, kompanitë e mëdha dhe palët e tjera të interesuara.

Rregullatorët në vendet e anëtarësimit në BE mund të konsiderojnë miratimin e VSME si një kornizë e detyrueshme për entitetet e mëdha që do të kualifikoheshin si NVM në pragun e BE-së.

Standardi VSME synon të zvogëlojë barrën mbi NVM-të duke minimizuar nevojën për t'iu përgjigjur kërkesave të shumta të veçanta të informacionit nga palët individuale për raportim, kujdes të duhur, menaxhim të rrezikut ose qëllime të tjera të lidhura me qëndrueshmërinë.

Raportimi i qëndrueshmërisë sipas standardit VSME mund të përmirësojë qasjen në financa të qëndrueshme dhe të ndihmojë NVM-të të kuptojnë dhe monitorojnë më mirë performancën e tyre të qëndrueshmërisë.

¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32025H1710>

Në përgjithësi, standardi VSME synon të:

1. **Përgjigjet ndaj kërkesave për të dhëna:** Ndiemon NVM-të të ofrojnë të dhëna të besueshme të qëndrueshmërisë për kompanitë e mëdha dhe palët e tjera të interesuara.
2. **Rrit qasjen në financa:** Rritja e transparencës për bankat dhe investitorët, duke mbështetur mundësi më të mira financimi për NVM-të.
3. **Përmirëson menaxhimin e qëndrueshmërisë:** Pajis NVM-të për të menaxhuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore dhe sociale në horizontet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.
4. **Ndërton një ekonomi më gjithëpërfshirëse:** Promovon pjesëmarrjen e SME-ve në përpjekjet e qëndrueshmërisë, duke kontribuar në një të ardhme më të gjelbër dhe më të drejtë.

Webinaret do të mbahen në platformën ZOOM dhe do të inçizohen. Pjesëmarrësit e regjistruar do të marrin detajet e lidhjes përpara çdo webinarit.

E RËNDËSISHME! Çdo seancë fillon në orën 13:00 CET dhe zgjat 90 minuta.

Gjuha e ngjarjes është anglishtja me përkthim simultan në shqip, boshnjak/kroatisht/serbisht dhe rusisht.

Webinarët organizohen në kuadër të programit rajonal të CFRR Përmirësimi i Programit të Kontabilitetit, Auditimit dhe Raportimit të Qëndrueshmërisë (EAASURE), bashkëfinancuar nga Ministria Federale Austriake e Financave, Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA).

Vendet pjesëmarrëse: Armenia, Azerbajxhani, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Ukraina. Vende të tjera në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore janë të ftuara si mysafirë.

Audienca e synuar: Përfaqësues të Ministrive të Financave përgjegjëse për legjislationin e raportimit të korporatave; rregullatorët bankarë dhe të sigurimeve, organizatat profesionale të kontabilitetit (PAO) dhe anëtarët e tyre (kontabilistët dhe auditorët), shoqatat e biznesit, përfaqësuesit e bankave tregtare, kompanive të sigurimeve, përfaqësuesit e kompanive të mëdha dhe të mesme (anëtarë të bordit, anëtarët e komitetit të auditimit, kontabilistët), përfshirë ndërmarrjet më të mëdha shtetërore, dhe akademikët.

Ndikimi: Seria e webinareve do t'i pajisë palët kryesore të interesit në rajon, veçanërisht ato në vendet anëtare të BE-së, me një kuptim më të qartë të fushëveprimit dhe zbatueshmërisë së standardit VSME, si dhe mbështetjen dhe udhëzimet e disponueshme për zbatimin. Përgatitësit e raportimit të detyrueshëm të qëndrueshmërisë do të fitojnë njohuri se si korniza e standardit VSME mund të mbështesë ofrimin e të dhënave të besueshme të qëndrueshmërisë për kompanitë e mëdha. SME-të do të kuptojnë më mirë se si t'u përgjigjen kërkesave për të dhëna nga institucionet financiare dhe palët e tjera të interesuara.

Rregullatorëve do t'u ofrohen prova mbështetëse për të informuar vendimet e politikave. Universitetet dhe ofruesit e tjerë të trajnimit mund të konsiderojnë integrimin e standardit VSME në kurrikulat e zhvillimit akademik dhe profesional.

Kjo nismë ka për qëllim të forcojë raportimin e qëndrueshmërisë dhe do t'i pozicionojë vendet pjesëmarrëse në mënyrë më të favorshme brenda peizazhit financiar rajonal dhe global.

RENDI I DITËS

DITA 1 | E ENJTE, 16 TETOR 2025 | SESIONI 1

Fjala e mirëseardhjes

13:00

Fabian Seiderer | Menaxher i Praktikës, Departamenti Global i Institucioneve, Banka Botërore
Saskia Slomp | CEO, EFRAG

Sesioni 1. Kuptimi i standardit VSME – Përmbajtja dhe fushëveprimi

13:15

Ky sesion do të prezantojë Standardin VSME, të zhvilluar nga EFRAG dhe miratuar nga Komisioni Evropian më 30 korrik 2025. Ai do të shpjegojë parimet për përgatitjen e raporteve të qëndrueshmërisë sipas standardit VSME, duke përfshirë dy modelet e raportimit: bazik dhe të avancuar.

Elisa Bevilacqua | Menaxher i lartë teknik i EFRAG

- Karakteristikat dhe objektivat kryesore të standardit VSME
- Qasja metodologjike dhe procesi i rregullt
- Struktura përfundimtare e standardit VSME

Lorenzo Baldini | Menaxher Teknik i Ri, EFRAG

- Shpjegime mbi Modulin bazë

Mathias Mingazzini | Menaxher Teknik i Ri, EFRAG

- Shpjegime mbi Modulin bazë

Moderator:

Svetlana Platon | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

Question and Answer Session

14:15

Folësit do të adresojnë pyetjet e paraqitura paraprakisht nga pjesëmarrësit ose të postuara gjatë webinarit.

14:30

Fundi i Sesionit 1

DITA 2 | E ENJTE, 23 TETOR, 2025 | SESIONI 2

Sesioni 2. Mbështetje dhe udhëzime për zbatimin – Burimet nga EFRAG

Ky sesion do të fokusohet në aspektet praktike të zbatimit të Standardit VSME, duke shfaqur materialet mbështetëse dhe udhëzimet e disponueshme në faqen e internetit të EFRAG.² Ai gjithashtu do të theksojë se si burimet e disponueshme mund të ndihmojnë përgatitësit të prodhojnë të dhëna të besueshme, të mbështesin rregullatorët në zhvillimin e politikave dhe t'u mundësojnë universiteteve dhe ofruesve të trajnimit të integrojnë standardin VSME në kurrikulat mësimore.

13:00

Elisa Bevilacqua | Menaxher i lartë teknik i EFRAG

- Pasqyrë e ekosistemit standard VSME
- Harta e mjeteve dhe platformave dixhitale

Lorenzo Baldini | EFRAG Menaxher Teknik i Ri

- VSME Standard udhëzues mbështetës dhe materiale të tjera mbështetëse edukative

Mathias Mingazzini | EFRAG Junior Technical Manager

- Modeli dixhital standard VSME

Moderator:

Svetlana Platon | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

14:00

Sesioni i pyetjeve dhe përgjigjeve

Speakers will address questions submitted by participants in advance or posted during the webinar.

14:20


Fjala përmbyllëse

Adrian Fozzard | Menaxher i Praktikës, Departamenti Global i Institucioneve, Banka Botërore

14:30

Fundi i ngjarjes

² <https://www.efrag.org/en/smes-and-sustainability-reporting>



Programi EAASURE
është një iniciativë e

 **Financial
Management**

 AN INITIATIVE OF
WORLD BANK GROUP

Programi EAASURE
bashkëfinancohet nga

 **Federal Ministry
Republic of Austria
Finance**

 **Austrian
Development
Cooperation**

 **Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra**

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO